



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 100/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.03.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

- Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.”, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-21386-07-18-2017, me objekt “*Shërbimi i pastrimit të zonës Tirana III*”, me fond limit 494.683.652 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.09.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës. Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Constrection” d.sh.h. në procedurën e mësipërme e prokurimit”.
- Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.”
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla nr. 2, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia e Tiranës
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.07.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-21386-07-18-2017, me objekt “Shërbimi i pastrimit të zonës Tirana III”, me fond limit 494.683.652 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 27.09.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar të datës 20.10.2017, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pastime Silvio” sh.p.k.
& “Er.Cav” Srl 440.306.450,1 lekë, skualifikuar
2. “Victoria Invest” sh.p.k. 455.120.199 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k.
& “Dion Texnikh A.E.” 460.308.404,40 lekë, skualifikuar
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Korsel” sh.p.k.
& “Brai Cata” Srl 470.663.330,29 lekë, skualifikuar
5. “Alko Impex General Contrustion” d.sh.h. 473.765.974 lekë, kualifikuar
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Be – Is” sh.p.k.
& “Sea” Srl & “Egland” sh.p.k. 484.329.326 lekë, skualifikuar
7. “Fusha” sh.p.k. 492.006.962 lekë, skualifikuar
8. “Infinit Construction” sh.p.k. 492.710.902 lekë, skualifikuar
9. “Rej” sh.p.k. 493.969.649 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 21.12.2017, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, bazuar në vendimin KPP 781/2017, datë 15.12.2017 të Komisionit të Prokurimit Publik, nga ku rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.” është kualifikuar.

II.4. Në datën 11.01.2018, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, referuar ankesave të paraqitura, nga ku rezulton se operatorët ekonomikë janë renditur si më poshtë vijon:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pastime Silvio” sh.p.k.
& “Er.Cav” Srl 440.306.450,1 lekë, skualifikuar
2. “Victoria Invest” sh.p.k. 455.120.199 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k.
& “Dion Texnikh A.E.” 460.308.404,40 lekë, skualifikuar
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Korsel” sh.p.k.
& “Brai Cata” Srl 470.663.330,29 lekë, skualifikuar
5. “Alko Impex General Contrustion” d.sh.h. 473.765.974 lekë, kualifikuar
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Be – Is” sh.p.k.
& “Sea” Srl & “Egland” sh.p.k. 484.329.326 lekë, skualifikuar
7. “Fusha” sh.p.k. 492.006.962 lekë, skualifikuar
8. “Infinit Construction” sh.p.k. 492.710.902 lekë, skualifikuar
9. “Rej” sh.p.k. 493.969.649 lekë, skualifikuar

II.5. Në datën 11.01.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.” është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- 1- *Operatori ekonomik "Shpresa" shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar të dokumentave të tenderit: "Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2017" pasi referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të shoqërisë "Shpresa" sh.p.k., në të cilën rezultoi se vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit në Qarkun Berat janë si më poshtë vijon: Berat, Lagja Kushtrim, Spitali Rajonal Berat dhe Berat, Poshnje, Kati i parë, Reparti Ushtarak Nr.1030 Poshnje, ndërkohë që shoqëria "Shpresa" sh.p.k. nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 nga Bashkia Berat çka bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 11 të ligjit 30.10.2016 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.*
- 2- *Bazuar në vendimin KSHA, referuar dokumentacionit të marrë në konsideratë dy vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Selanik Nr. 76080/18750 dhe 76083/18751 nuk janë të njëjta me ato të dorëzuara në SPE.*
- 3- *Kontrata e bashkëpunimit midis shoqërive dhe prokura e lëshuar nuk janë nënshkruar para noterit pasi administratori D.D nuk ka hyrë asnjëherë në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në nenin 47 të LPP, i ndryshuar, këto fakte të ngritura në pretendim janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.6. Në datën 15.01.2018, bashkimi i operatorëve ekonomikë "Shpresa" sh.p.k. & "Dion Texnikh A.E.", ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor, si edhe duke ngritur pretendime në lidhje me operatorët ekonomikë të kualifikuar. Konkretisht ankimesi pretendon si më poshtë vijon:

[...]

Duke iu referuar arsyeve të sipërpërmendura, çmojmë se autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka skualifikuar BOE "Shpresa" sh.p.k. & "Dion Texnikh A.E." në kundërshtim me LPP. Ky qëndrim është i njëanshëm, i qëllimshëm, i pabazuar në ligj dhe në tejkalim të kompetencave që ka një autoritet kontraktor, duke marrë si të vërteta pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, për të cilin jo pak herë janë ngritur pretendime të provuara për falsifikime dokumentash apo dokumenta të rreme për qëllim kualifikimi. Më poshtë po paraqesim sqarimet në lidhje me arsyet e skualifikimit.

- 1- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit, referuar vendimit të KSHA ju informojmë se bashkimi i operatorëve ekonomikë "Shpresa" sh.p.k. & "Dion Texnikh A.E." e plotëson pikën 3 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar "Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2017" në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ku pika 2 thotë (cituat) [...]. Referuar VKB nr.59, datë 30.12.2015 Për kategorinë II Biznesi detyrimi paguhet brenda datës 30 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit ku shoqëria jonë i ka përmbushur në mënyrë korrekte pikën si më lart. Konkretisht, rezultoi se provuar nëpërmjet vërtetimit të ngarkuar në SPE me nr. Prot 520 që shoqëria "Shpresa" sh.p.k. ka likuiduar detyrimet e taksave vendore në Qarkun Berat për vitin 2017. Referuar ankesës tjetër në qarkun Berat, me objekt shërbim lavaxion, sipas ekstraktit të QKB vihet re që është hapur në muajin qershor dhe pagesa është kryer brenda 30 ditësh nga hapja e kësaj adrese në përputhje të plotë me pikën 2 të nenit 11 të ligjit "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Referuar VKB nr.59, datë 30.12.2015 Për kategorinë II Biznesi detyrimi paguhet brenda datës 30 prill.*

Shoqëria jonë i ka paguar brenda afatit të përcaktuar të gjitha detyrimet për taksat vendore për vitin 2017. Pas kryerjes së të gjitha pagesave jemi pajisur me vërtetimet përkatëse për vitin 2017. Ndërkohë që afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit, sipas ekstraktit të QKB, hapja e kësaj adrese është bërë në një periudhë të mëvonshme, ku edhe nga ana e shoqërisë është kryer pagesa në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. Për sa më lart, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që ti shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Që shoqëria “Shpresa” sh.p.k. ka kapacitet teknik e financiar për të përmbushur shërbimin e prokuruar rezulton i provuar edhe nga fakti që kjo shoqëri, përveç zyrës qendrore, ka të regjistruar edhe 11 (njëmbëdhjetë) vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit për të cilat ka paguar brenda afatit të përcaktuar të gjitha detyrimet në Bashkitë përkatëse ku janë paraqitur vërtetimet në këtë procedurë. Për sa më lart pretendimi se shoqëria “Shpresa” sh.p.k. nuk ka paguar taksat në qarkun e Beratit nuk qëndron. Evidentojmë gjithashtu se referuar Ekstraktit të Regjistrat Tregtar shoqëria i regjistron vazhdimisht dhe rregullisht cdo vend të ushtrimit të aktivitetit, në dallim nga shoqëria “e kualifikuar” nga ana juaj “Alko Impex General Construction” sh.p.k., që ka të regjistruar vetëm zyrën qendrore dhe asnjë vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit me qëllimin e vetëm të shmangies së detyrimeve sic rëndom vepron kjo shoqëri. Midis vendeve të shumta që ushtron aktivitet, kjo shoqëri ushtron aktivitet në qytetin e Kavajës me të njëjtin objekt prokurimi si në këtë procedurë që prej vitit 2015 e në vazhdim, të cilin nuk e ka të regjistruar në QKB dhe rrjedhimisht nuk paguan asnjë detyrim. Pavarësisht sqarimeve si më lart, në kuptim të nenit 55 pika 2 të LPP, i ndryshuar, (citar) [...]. Konkretisht është kërkuar: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017”. Pra në asnjë pikë të DST nuk është kërkuar që OE duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin qofshin këto ndryshe nga objekti i prokurimit. Pavarësisht se shoqëria jonë ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për 11 vende të ushtrimit të aktivitetit, për sa kohë në kërkesat e tenderit nuk kërkohet vërtetim për shlyerjen e taksave vendore edhe për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, KSHA nuk mund të ngrejë asnjë lloj pretendimi. Arsyeja e mësipërme e skualifikimit nuk qëndron.

- 2- *Për sa i përket arsyes së dytë të skualifikimit, theksojmë se Bashkia Tiranë qëllimisht është bazuar në dokumentat e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues. Nëse autoriteti kontraktor do të kishte dyshime për vërtetësinë e tyre, kopjet origjinale të vërtetimeve mund të viheshin atij në dispozicion nga ana e shoqërisë tonë, me qëllim që autoriteti të kishte mundësinë e kryerjes së një akti ekspertimi për të parë nëse vërtetimet janë të rregullta. Madje e drejta e autoritetit kontraktor për të kërkuar sqarime është parashikuar edhe në nenin 53 të LPP (citar) [...].*

Akoma më tej autoriteti kontraktor nëse do të kishte dyshime, mund të dërgonte shkresë zyrtare pranë Bashkisë Selanik për të konfirmuar vërtetësinë ose jo të dokumentave në fjalë. Sqarojmë se nëpërmjet vërtetimit lëshuar nga Bashkia Selanik me nr. 76080/18750 për shoqërinë “Dion Texnikh A.E” dhe Nr. 76083/18751 Z. Dimitrios Dyonisopoulos, vërtetohet si shoqëria ashtu edhe individi Z. Dimitrios Dyonisopoulos nuk kanë detyrime në arkën e Bashkisë lidhur me fondin e saj. Ky vërtetim nuk shërben si provë për likuidimin e detyrimeve të taksave vendore, pasi sjellim në vëmendje se në shtetin Grek, ndryshe nga shteti jonë, detyrimet e taksave vendore nuk paguhen pranë bashkive përkatëse, por paguhen për Korporatën Elektroenergjitike të Greqisë nëpërmjet faturës së energjisë elektrike. Për këtë shkak, për vërtetimin e mosekzistencës së detyrimeve për taksat vendore, vërtetimi përkatës nuk lëshohet nga Bashkia kur taksat nuk paguhen pranë këtij institucioni, por si dokumenta provues shërbejnë vetëm faturat e energjisë elektrike, (në të cilën detajohen edhe taksat vendore), mandatpagesat si dhe vetëdeklarimi i subjektit përkatës. Që shoqëria “Dion Texnikh A.E” i ka likuiduar detyrimet për taksat vendore rezulton e provuar si nga likuidimi i faturave të energjisë elektrike, mandat pagesat përkatëse (në të cilat janë detajuar pagesa e taksave vendore) ashtu edhe nga vetëdeklarimi i këtij subjekti; dokumentacion ky i cili është paraqitur edhe në ofertë në cilësinë e provës. Në këtë kuptim si edhe për shkaqet sa më sipër, evidentojmë se vërtetimi lëshuar nga Bashkia Selanik me nr. 76080/18750 për shoqërinë “Dion Texnikh A.E” dhe nr. 76083/18751 për Z. Dimitrios Dyonisopoulos nuk përbëjnë dokumentacion provues në lidhur me përmbushjen e kriterit kualifikues “vërtetim për pagimin e taksave vendore”. Për rrjedhojë, këto vërtetime nuk mund të përbëjnë as shkak skualifikimi. Arsyeja se përse shoqëria “Shpresa” sh.p.k. i ka paraqitur me dokumentacionin e saj këto dy vërtetime lidhet me qëllimin për ti vërtetuar me një dokumentacion sa më të plotë (tej atyre të kërkuar në dst) autoritetit kontraktor seriozitetin e BOE si për emrin tregtar të shoqërive pjesmarrëse ashtu edhe në përpikmërinë e korrektësinë e tyre në ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Në këtë aspekt, sjellim se në një rast të mëparshëm, të ngjashëm shërbimin objekt prokurimi, Bashkia Tiranë ka skualifikuar shoqërinë “Victoria Invest” sh.p.k. për mosvërtetimin e detyrimeve në arkën e bashkisë. Por ky dokument në atë procedurë ka qenë kriter kualifikues. Pikërisht për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, i cili në procedurën aktuale nuk është përcaktuar si i tillë, BOE “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh A.E” ka paraqitur këtë dokumentacion shtesë. Ndodhur në këto kushte, çmujmë se shoqëria “Shpresa” sh.p.k. nuk mund të skualifikohet për vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Selanik nr. 76080/18750 dhe 76083/18751, pasi siç edhe më sipër cituam, këto vërtetime nuk përbëjnë dokument justifikues për vërtetimin e likuidimit të detyrimeve të taksave vendore. Për të dyja këto vërtetime shoqëria “Shpresa” sh.p.k. disponon edhe kopjet origjinale të tyre. Gjithashtu sqarojmë se mospërputhja e konstatuar nga autoriteti kontraktor për vërtetimet në fjalë nuk ka synime mashtrimi pasi të dyja vërtetimet që shoqëria “Shpresa” sh.p.k. disponon, kanë të njëjtën përmbajtje si dhe pasqyrojnë të njëjtin fakt; mospasjen e detyrimeve në arkën e Bashkisë Selanik nga: 1. Shoqëria “Dion Texnikh A.E” dhe 2. Z. Dimitrios Dyonisopoulos. I vetmi ndryshim në përmbajtje midis vërtetimit të parë dhe atij të dytë, të cilët theksojmë se mbajnë të njëjtën datë përpilimi, ka të bëjë me afatin e vlefshmërisë së tyre.

Konkretisht, për vërtetimin e parë, afati i vlefshmërisë sipas përmbajtjes së tij është deri në datën 24.09.2017. Ndërsa vërtetimi i dytë nuk ka afat vlefshmërie. Arsyeja se përse nga ana e Bashkisë Selanik është lëshuar vërtetimi i dytë ka të bëjë me faktin se afati i vlefshmërisë së vërtetimit të parë është për një periudhë 1 muajore (nga data 24.08.2017 deri në datën 24.09.2017) – në një kohë që afati i vlefshmërisë për këtë vërtetim, sipas nenit 4 të ligjit nr. 4174, datë 27.12.2013, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.170 A të Republikës së Greqisë, duhej të ishte 2 muaj nga data e lëshimit (shih bashkëlidhur ligjin e përkthyer). Pra duke qenë se Bashkia Selanik kishte lëshuar një vërtetim i cili vinte në kundërshtim me dispozita urdhëruese të ligjit, i cili në rats se do të kërkohej si dokument do të cënonte thelnësisht interesat tanë, nëpërmjet vërtetimit të dytë ka bërë korigjimin përkatës. Pra, për të gjithë sa më sipër, çmojmë se vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Selanik nr. 76080/18750 dhe 76083/18751 janë tërësisht të rregullta si në formë ashtu edhe në përmbajtje dhe se pretendimet e shoqërisë “Alko Impex” sh.p.k. dhe qëndrimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron dhe madje është krejtësisht i padrejtë, diskriminues dhe tendencioz kundrejt BOE “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh A.E”. Shoqëria jonë është një shoqëri tepër serioze, e cila ka shumë vite që operon në treg, duke ofruar shërbime të ndryshme publike dhe private dhe e cila nuk ka dhe nuk do të ketë asnjëherë probleme të kësaj natyre; në dallim nga shoqëria “Alko – Impex” sh.p.k. e cila e ka praktikë pune falsifikimin e dokumentave zyrtare dhe private me qëllim përfitimin e vlerave monetare në procedurat e prokurimit publik në të cilat ajo merr pjesë. Kemi dijeni për një kontratë të ngjashme, të falsifikuar e cila është paraqitur pranë Bashkisë Tiranë në procedurën e hapur me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, sheshi Skënderbej” në cilësinë e dokumentit i cili provon përvojat e ngjashme, për të cilin Bashkia Tiranë ka heshtur. Një rast tjetër konkret është në procedurën e zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ku kjo shoqëri është skualifikuar pasi kishte paraqitur kontratë të rreme furnizimi me asfaltbeton për qëllime kualifikimi. Gjithashtu në një procedurë për ndërtim Ujësjetës Përrenjas e mjaft procedura të tjera.

- 3- Për sa i përket arsyes së tretë të skualifikimit, se kontrata e bashkëpunimit mes shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Dion Teknikh A.E” dhe prokura nuk janë nënshkruar përpara noterit, pasi administratori D.D nuk ka hyrë asnjëherë në Republikën e Shqipërisë është tërësisht i pasaktë dhe jashtë kompetencave të Bashkisë Tiranë. Kjo për arsyen se për nënshkrimin e akteve më sipër, noterja M.D është paraqitur në shtetin Grek për të marrë nënshkrimin e administratorit të shoqërisë “Dion Texnikh A.E”, shtetasit D.D. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm në sistemin TIMS, nëpërmjet të cilit vërtetohen më shumë se një herë hyrje daljet e noteres në shtetin Grek. Pra, krejtësisht e qartë në SPE që aktet e sipërcituar, ndryshe nga çfarë pretendon shoqëria “Alko Impex” sh.p.k. janë lexuar dhe nënshkruar para noteres M.D. theksojmë se nuk ka asnjë dispozitë ndaluese në ligjin “Për noterinë”, që noterja të marrë nënshkrimin e palëve për aktet e redaktuara prej saj jashtë zyrës së noterisë.

Për më tepër që në asnjë pikë të këtyre akteve nuk është cituar që janë nënshkruar në Shqipëri apo në zyrën noteriale të noteres. Nëse pretendimi i shoqërisë “Alko Impex” sh.p.k. do të ishte i vërtetë, qëndrim ky i miratuar edhe nga Bashkia e Tiranë, atëherë, do të ishim përballë faktit noterja ka kryer vepër penale. Këto akte noteriale janë hartuar nga Notere M.D në përputhje të plotë me ligjin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ka genë prezente në Greqi noterja në momentin e leximit dhe nënshkrimit të kontratës dhe prokurës nga ana e Z. Dimitrios Dionysopoulos. Veç sa më sipër, theksojmë se këto dokumenta janë akte noterial, të hartuara nga një person i cili ushtron veprimtari publike siç është noteri dhe për pasojë përbëjnë akte zyrtare. Aktet zyrtare përbëjnë provë të plotë për vërtetësinë e deklarimeve të bëra përpara nëpunësit publik si dhe për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, ose për veprimet e kryera prej tyre. Kundër përmbajtjes së akteve zyrtare lejohet të provohet e kundërta vetëm nëse ato goditen për fallsitet. Për aq kohë sa aktet noteriale nuk janë goditur për fallsitet çmohet se si Bashkia Tiranë ashtu edhe shoqëria “Alko Impex” sh.p.k. nuk kanë të drejtë të dyshojnë për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre, por duhet ti marrin të mirëqena e pasqyruara në to. Kjo në përputhje edhe me nenin 47 të LPP [...]. Për sa më sipër, nëse autoriteti ka dyshime për vërtetësinë e dokumenteve ai ka çdo të drejtë të ndjekë hapat ligjor përkatës duke mos arritur në përfundime jo të sakta. Theksojmë edhe njëherë se BOE “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Teknikh A.E”, duke ju referuar sqarimeve të përmendura më lart: Nuk ka paraqitur asnjë të dhënë të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi. Për këtë shkak, çmohet se edhe kjo arsye e dhënë nga autoriteti kontraktor për skualifikimin e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. nuk qëndron. Akoma më tej, vetëm duke u bazuar në një vërtetim të marrë në mënyrë jo të rregullt nga sistemi TIMS për Z. Dimitrios Dionysopoulos pasi asnjë nuk ka të drejtën e aplikimit përveç prokurorisë, gjykatës, vetë personit ose kushdo me prokurë të posaçme nga vetë personi. Pra Bashkia Tiranë bazohet në mënyrë të njëanshme në një vërtetim të marrë jo në mënyrë ligjore, duke bashkëpunuar me operatorin ankimues dhe duke mos kërkuar asnjë sqarim nga ana e BOE “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Teknikh A.E”. Për të gjithë sa sipër cituam, kërkojmë pranimin e kësaj ankese duke u vendosur kualifikimi i menjëhershëm i shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Teknikh A.E”. nga ana tjetër kualifikimi i operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” sh.p.k. është në kundërshtim të hapur me LPP duke u favorizuar në mënyrë të padrejtë dhe abuzive nga ana e autoritetit kontraktor për arsye si më poshtë:

- 1- Licenca e shoqërisë “Alko Impex General Construction” sh.p.k. me kod III 2 A është e pavlefshme që në datë 04.04.2017. Kjo shoqëri merr pjesë në procedura prokurimi, operon me këtë licencë që është automatikisht e revokuar dhe përdoret me qëllim mashtrimi, përfitimi dhe kualifikimi. Kjo në kuptim të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” neni 12, pika 1 dhe pika 5 [...].Referuar të dhënave të Ekstraktit historik të shoqërisë “Alko Impex General Construction” rezulton se në datë 14.03.2017 është emëruar si administrator Z.E.T *kusht ky për tu pajisur me Licencë me kod III 2 A që shoqëria duhet të ketë detyrimisht një administrator të pajisur me certifikatë për vlerësim dhe auditim mjedisor.) Kjo datë përkon me lëshimin e licensës me kod III 2.A nga QKL me 20.03.2017. Sipas të dhënave që disponojmë kjo shoqëri nuk e ka deklaruar Z.E.T (administrator) në sistemin tatimor, por akoma më tej e ka hequr si administrator në datë 04.04.2017 dhe është lehtësisht e verifikueshme që ky person nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë për këtë periudhë. Me largimin e tij, licenca rezulton automatikisht e pavlefshme.*

Këtë e vërteton dhe përgjigja bashkëngjitur që kemi marrë nga QKL ku akoma si administrator rezulton z.E.T dhe pse është larguar nga kjo shoqëri dhe nuk rezulton i zëvendësuar me administrator tjetër të pajisur me certifikatë për vlerësim dhe auditim mjedisor.

- 2- Referuar ekstraktit të QKR “Alko Impex General Construction” ka të regjistruar vetëm adresën qendrore Rr. Reshit Petrela, Kompleksi Usluga, Tiranë dhe nuk ka të regjistruar asnjë vend tjetër ushtrim aktiviteti me qëllimin e vetëm për të shmangur detyrimet. Kjo shoqëri ushtron aktivitet me objektin e prokurimit për vitin 2017 në qytetin e Kavajës ku ka lidhur kontratë me Bashkinë Kavajë nr. 178/3 datë 25.03.2016/ Bazuar në këtë kontratë, duhet të ketë detyrimisht një vend për parkimin e automjeteve brenda territorit të qytetit të Kavajës sipas kërkesave të tenderit por që nuk rezulton të jetë regjistruar në QKB, rrjedhimisht nuka ka paguar taksat vendore. Gjatë vitit 2017 ka kryer aktivitet në qytetin e Librazhdit, Peqinit, Bilishtit, Pukës, Dibrës duke mos i regjistruar si vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit dhe për rrjedhojë nuk ka paguar taksat vendore. Duke u bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 41, pika 2 [...], neni 43 [...]. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 40, nenin 3.1/a.b.c të ligjit nr. 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit” si dhe ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” i ndryshuar në ligji “Për regjistrimin e biznesit”, neni 62, “Certifikatat e regjistrimit fillestar” ku përcaktohet [...]. Por mosregjistrimi dhe mospagesimi në Ekstraktin e QKB-së, për vendet e tjera të zhvillimit të aktivitetit, ka sjellë edhe mospagesën e detyrimeve vendore në këto njësi ku ka zhvilluar aktivitet. Pagesave e taksave vendore për cdo biznes përcaktohet në ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.*
- 3- Në pikën 3 të DST, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, për punonjësit si: 1 (një) Inxhinier Mjedisi, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Në dijeninë tonë shoqëria “Alko Impex General Construction” nuk plotëson pikën 3 të DST ku të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier mjedisi, të pajisur me Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe CV i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, (shkurt – korrik 2017). Inxhinieri i pajisur me Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është punësuar pranë kësaj kompanie në muajin Maj dhe ka mungesë dokumentacioni.*
- 4- Në pikën 14 të DST, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat: “Specifikime teknike”, të firmosura e vulosura dhe grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike. Dyshojmë se shoqëria “Alko Impex General Construction” nuk ka paraqitur Grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit pasi kjo shoqëri nuk ka kapacitetet dhe përvojën për kryerjen e këtij shërbimi. Sqarojmë se grafiku i shërbimit është një nga elementët e domosdoshëm dhe kryesorë të shërbimit të pastrimit. Si është e mundur që autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë të anashkalojë këtë pikë të rëndësishme duke e kualifikuar këtë operator?*

- 5- Sipas pikës 11 të DST: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet. Dyshojmë se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve është e paplotë duke mos i përfshirë të gjitha mjetet e kërkuara.
- 6- Sipas pikës 12 Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11 gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: e) Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e Porosisë/Kontrata e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshjen e Porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (original ose kopje e noterizuar). Sipas informacioneve që disponojmë për kompaninë me të cilën është lidhur akt marrëveshja e porosisë, mendojmë se nuk është paraqitur katalog për secilin mjet të porositur sipas kërkesës ku Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar).
- 7- Sipas pikës 12 nga të dhënat që disponojmë, mjetet në pronësi apo me qira të shoqërisë “Alko Impex General Construction” nuk i plotësojnë të dhënat teknike dhe sasitë e kërkuara. Rrjedhimisht dokumentacioni për mjetet është i pasaktë. Për sa më sipër argumentuam, kërkojmë: 1. Kualifikimin e BOE “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh A.E” pasi i plotëson të gjitha kriteret kualifikuese dhe i kursen buxhetit të shtetit një vlerë prej 13.457.570 lekë pa Tvsh. 2. Skualifikimin e OE “Alko Impex General Construction” pasi është kualifikuar në kundërshtim të hapur me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

II.7. Në datën 22.01.2018, me shkresën nr. 1998/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, duke mos e pranuar ankesën e tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

[...]

1. Për sa i përket pretendimit tuaj në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga operatori i huaj ekonomik “Dion Texnikh” A.E ju bëjmë me dije se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh” A.E nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit se të gjithë pretendimet dhe faktet e paraqitura në ankesën e operatorit ekonomik “Alko Impex General” degë e shoqërisë së huaj janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, datë 04.01.2018. Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh” A.E nuk qëndron.

2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet që lindin nga taksat vendore për Qarkun Berat, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se shoqëria “Shpresa” sh.p.k. ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në vendin e ushtrimit të aktivitetit Bashkia Ura Vajgurore, ndërkohë që nuk është dorëzuar asnjë vërtetim në lidhje me vendin e ushtrimit të aktivitetit Bashkia Berat, ku referuar ekstraktit mbi historikun e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. rezulton se ky vend ushtrimi aktiviteti është hapur në vitin 2017 dhe vijon të jetë aktiv në këtë bashki. Në këto kushte bazuar në nenin 46 të LPP, i ndryshuar, nenin 53, pika 3 të LPP, të ndryshuar dhe nenin 74 pika 3 të VKM 914, të ndryshuar.

KSHA gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar ankesës së dorëzuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh” A.E i referohet termi “Qarku Berat”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nënvizon se referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në nenin 3;4 dhe vijues parashikon se detyrimet që rrjedhin nga tatimet dhe taksat vendore lindin dhe paguhen pranë cdo njësie të ushtrimit të aktivitetit në bashkinë përkatëse. Në asnjë rast ligji i posacëm nuk parashikon lindjen dhe pagimin e detyrimeve në Qark, por në Bashki. Subjekti megjithëse ushtron aktivitet tregëtar pranë Bashkisë Berat dhe ndaj së cilës kanë lindur detyrimet përkatëse, nuk disponon asnjë vërtetim të lëshuar nga kjo bashki për shlyerjen e taksave vendore. Gjithashtu referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku parashikohet se “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017; Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR. Sa më sipër, KSHA gjykon se vetë në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, Njësia e Prokurimit ka theksuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dorëzojnë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga taksat vendore, në cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas QKR. Pra shoqëria disponon aktivitet tregëtar të regjistruar në QKR në Bashkinë Berat, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve në këtë bashki. Për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, në lidhje me kërkimin e mësipërm, KSHA i drejtohet për interpretim edhe vendimeve të organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, Komisioni i Prokurimit Publik, kun ë vendimin KPP 709/2017 ka mbajtur të njëjtin qëndrim me arsyetimin e mësipërm në lidhje me plotësimin e vërtetimit për taksat vendore. Sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

3. Lidhur me pretendimet e ngritura për operatorin ekonomik “Alko Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj, KSHA vlerëson se: Neni 63, pika 1 e LPP, I ndryshuar, me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon [...]. KSHA sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimes edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Në lidhje me pretendimet e ngritura për dokumentacionin e dorëzuar në procedura të ndryshme prokurimi, KSHA gjykon se nuk ka objekt shqyrtimi, pasi janë lidhur me procedura të tjera prokurimi të cilat nuk kanë lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe pa asnjë interes në shqyrtimin administrative në fjalë. Sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron. Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk pranon ankesën e paraqitur bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh” A.E.

II.8. Në datën 24.01.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, si edhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik të kualifikuar.

Oferta jonë është skualifikuar me pretendimin se:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” shpk & “Dion Texnikh” A.E nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarde të Tenderit:

- 1. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për Vitin 2017, pasi referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregëtar të shoqërisë “Shpresa” shpk, në të cilën rezulton se vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit në Qarkun Berat janë si më poshtë vijon: Berat, Lagjja Kushtrim, Spitali Rajonal Berat dhe Berat, Poshnje, Kati i Pare, Reparti Ushtarak Nr.] 03 0 Poshnje, ndërkohë që shoqëria “Shpresa” shpk nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 nga Bashkia Berat cka bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 1] të ligjit 30.10.2016, “Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar.*
- 2. Bazuar në vendimin e KSHA, referuar dokumentacionit të marrë në konsideratë dy vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Selanik Nr. 76080 18750 dhe 76083 18751 nuk janë të njëjta me ato të dorëzuar në SPE. Kontrata e bashkëpunimit mes shoqërive dhe prokura e lëshuar nuk janë nënshkruar para noterit, pasi administratori DD nuk ka hyrë asnjëherë në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (I ndryshuar), këto fakte të ngritura në pretendim janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik. Duke iu referuar arsyeve të sipërpërmendura, cmojmë se Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë ka skualifikuar BOE “Shpresa” shpk dhe “Dion Texnikh A.E” në kundërshtim të hapur me Ligjin e Prokurimeve Publike. Ky qëndrim është i njëanashëm, i qëllimshëm, i pabazuar në ligj dhe në tejkalim të kompetencave që ka një Autoritet Kontraktor, duke i marre për bazë pretendimet e operatorit ankimes. Këtë e konfirmon dhe kthim përgjigjia e ankesës datë 22.01.2018*

I. Pika 1. Për sa i përket pretendimit Tuaj në lidhje me vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga operatori i huaj ekonomik “Dion Texnikh” A.E. Komisioni Vleresimit të Ofertave ka njoftuar BOE “Shpresa” shpk & “Dion Texnikh” A.E se të gjitha pretendimet dhe faktet e paraqitura në ankesën e Operatorit Ekonomik “Alko Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, datë 04.01.2017. Sa më sipër pretendimi i palës ankimese nuk qëndron. Për sa më lart është krejtësisht e qartë që Autoriteti Kontraktor mban qëndrim të njëanshëm dhe diskriminues, duke marrë në konsideratë pretendime dhe dokumenta të paraqitura nga OE ankimes të nxjerra në mënyrë jo ligjore si nga Konsullata e Shqipërisë dhe nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit për të cilat kemi vënë në dijeni organet kompetente për mënyrën e lëshimit të këtyre dokumentave pa dijeninë e personit në fjalë Z. Dimitrios Dionysopoulos.

Nëse Autoriteti Kontraktor do të kishte pretendime për vërtetësinë e dokumentave në Balë, kopjet origjinale të vërtetimit mund të vihehin në dispozicion nga ana e shoqërisë sonë, me qëllim që Autoriteti të kishte mundësinë e kryerjes së një akti ekspertimi për të parë nëse vërtetimet janë të rregullta.

Madje e drejta e Autoritetit Kontraktor për të kërkuar sqarime është parashikuar edhe në nenin 52 të Ligjit të Prokurimeve Publike “Shqyrtimi i ofertave”, sipas të cilit “1. Autoriteti Kontraktor kur e shikon të arsyeshme u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, për shirë ndryshimet në cmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Akoma më tej Autoriteti Kontraktor nëse do të kishte dyshime mund të kërkonte shkresë zyrtare pranë Bashkisë Selanik për të konfirmuar vërtetësinë ose jo të dokumentave në fjalë. Ndërkohë që edhe sqarimet dhe provat e paraqitura në ankesën për kundërshtimin e vendimit të KSHA nuk janë marrë në konsideratë apo të dërgohen pranë APP-së për një hetim sa më të saktë të kësaj çështje.

1.1 Sqarojmë se mospërputhja e konstatuar nga Operatori Ekonomik “Alko Imëx General Construction” për vërtetimet në fjalë nuk ka synime mashtrime pasi të dyja vërtetimet origjinale të lëshuara nga Bashkia Selanik që shoqëria “Shpresa” sh.p.k. disponon, kanë të njëjtën përmbajtje si dhe pasqyrojnë të njëjtin fakt: mospasjen e detyrimeve në arkën e Bashkisë Selanik nga: 1. Shoqëria “Dion Texnikh A.E” dhe 2. “Z” Dimitrios Dyonisopoulos. I vetmi ndryshim në përmbajtje midis vërtetimit të parë dhe atij të dytë, të cilët theksojmë së mbajnë të njëjtën datë përpilimi, ka të bëjë me afatin e vlefshmërisë së tyre. Konkretisht, për vërtetimin e parë, afati i vlefshmërisë sipas përmbajtjes së tij është deri në datën 24.09.2017. Ndërsa vërtetimi i dytë nuk ka afat vlefshmërie. Arsyeja se përse nga ana e Bashkisë Selanik është lëshuar vërtetimi i dytë sipas kërkesës tonë, ka të bëjë me faktin se afati i vlefshmërisë së vërtetimit të parë është për një periudhë 1 muajore (nga data 24.08.2017 deri në datën 24.09.2017) në një kohë që afati i vlefshmërisë për këtë vërtetim, sipas nenit 4 të ligjit Nr. 4174, datë 27.12.2013, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 170 A të Republikës së Greqisë, duhej të ishte 2 muaj nga data e lëshimit (shih bashkëlidhur ligjin e perkthyer). Pra, duke qenë se Bashkia Selanik kishte lëshuar një vërtetim i cili vinte në kundërshtim me dispozita urdhëruese të ligjit, i cili në rast se do kërkohej si dokument do të cënonte thelbësisht interesat tonë, nëpërmjet vërtetimit të dytë ka bërë korrigjimin përkatës.

Pavarësisht sqarimit sa më lart ju informojmë se vërtetimi lëshuar nga Bashkia Selanik me Nr 76080/18750 për shoqërinë “Dion Texnikh A E” dhe Nr 76083/18751 Z. Dimitrios Dyonisopoulos vërtetohet si shoqëria ashtu edhe individi Z. Dimitrios Dyonisopoulos nuk kanë detyrime në arkën e Bashkisë lidhur me fondin e saj. Ky vërtetim nuk shërben si provë për likuidimin e detyrimeve të taksave vendore, pasi sjellim në vëmendje se në shtetin Grek, ndryshe nga shteti jone, detyrimet e taksave vendore nuk paguhen pranë Bashkive përkatëse por paguhen në Korporatën Elektroenergjetike të Greqisë nëpërmjet faturës së energjisë elektrike. Për këtë shkak, për Vërtetimin e mosekzistencës së detyrimeve për taksat vendore, Vërtetimi përkatës nuk lëshohet nga Bashkia kur taksat nuk paguhen pranë këtij institucioni por si dokumenta provues shërbejnë vetëm faturat e energjisë elektrike, (në të cilën detajohen edhe taksat vendore), mandatpagesat si dhe vetëdeklarimi i subjektit përkatës.

Që shoqëria “Dion Texnikh A.E” i ka likuiduar detyrimet per taksat vendore rezulton e provuar si nga likuidimi i faturave të energjisë elektrike, mandat pagesat përkatëse(në të cilat janë detajuar pagesa e taksave vendore) ashtu edhe nga vetëdeklarimi i këtu subjekti ; dokumentacion ky i cili është paraqitur edhe në ofertë në cilësinë e provës.

Në këtë kuptim si dhe për shkaqet sa më sipër, evidentojmë se vërtetimi lëshuar nga Bashkia Selanik me Nr 76080/ 18750 për shoqërinë “Dion Texnikh A.E” dhe Nr 76083/18751 për Z. Dimitrios Dyonisopoulos nuk përbëjnë dokumentacion provues lidhur me përmbushjen e kriterit kualifikues “vërtetim për pagimin e taksave vendore”. Për rrjedhojë këto vërtetime nuk mund të përbëjnë as shkak skualifikimi.

Arsyeja se përse shoqëria “Shpresa“ sh.p.k i ka paraqitur në dokumentacionin e saj këto dy vërtetime lidhet me qëllimin për ti vërtetuar me një dokumentacion sa më të plotë (tej atyre të kërkuar në DST) Autoritetit Kontraktor seriozitetin e BOE si për emrin tregëtar të shoqërive pjesëmarrëse ashtu edhe në përpikmërinë e korreksionit të tyre në ushtrimin e veprimtarisë tregëtare. Në këtë aspekt, sjellim se në një rast të mëparshëm, të ngjashëm shërbimit objekt prokurimi, Bashkia Tiranë ka skualifikuar shoqërinë “Victoria Invest” sh.p.k për mosvërtetimin e detyrimeve në arkën e Bashkisë. Por ky dokument në atë procedurë ka qënë kriter kualifikues. Pikërisht për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, i cili në procedurën aktuale nuk është përcaktuar si i tillë, BOE “Shpresa” sh.p.k dhe “Dion Texnikh A.E” ka paraqitur këtë dokumentacion shtesë.

Ndodhur në këto kushte cmojmë se shoqëria “Shpresa” sh.p.k. nuk mund të skualifikohet duke u bazuar në këto vërtetime sicc edhe më sipër cituam, këto vërtetime nuk përbëjnë kriter kualifikues dhe justifikues për vërtetimin e likuidimit të detyrimeve të taksave vendore pasi edhe njëherë theksojmë se taksat vendore të Bashkisë paguhen pranë Korporatës Elektroenergjetike. Në asnjë pikë të DST nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për mospasje detyrimesh në arkën e Bashkisë.

Pretendim i mësipërm marrë në shqyrtim nuk qëndron.

1.2 Pretendimi tjetër i marrë në konsideratë dhe i derguar pranë APP-se se kontrata e bashkëpunimit mes shoqërisë “Shpresa” sh.p.k dhe shoqërisë “Dion Texnikh A.E” si dhe prolmra nuk janë nënshkruar para noterit, pasi administratori D.D nuk ka hyrë asnjëherë në Republikën e Shqipërisë është tërësisht i pasakatë dhe jashtë kompetencave të Bashkisë Tiranë. Kjo për arsyen se për nënshkrimin e akteve më sipër, noterja M.D është paraqitur në shtetin Grek për të marrë nënshkrimin e administratorit të shoqërisë “Dion Texnikh A.E”, shtetasit D.D. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshem në sistemin TIMS bashkëlidhur, nëpërmjet të cilit vërtetohen hyrje daljet e noterës në shtetin Grek.

Pra, është krejtësisht e qartë në SPE që aktet e sipërcituar, ndryshe nga çfarë pretendon shoqëria “Alko-Impex General Construction” sh.p.k dhe KSHA, janë lexuar dhe nënshkruar para noterës M.D. Theksojmë se nuk ka asnjë dispozitë ndaluese në ligjin “Për noterine”, qe notetja te marre nënshkrimin e paleve per aktet e redaktuara prej saj jashte zyres se noterise. Per me teper qe 93 asnje pikë të këtyre akteve nuk është cituar që janë nënshkruar në Shqipëri apo në zyrën noteriale të noterës.

Nese pretendimi i shoqërisë “Alko-Impex General Construction” sh.p.k do te ishte i vertete, qendrim ky i miratuar edhe nga Bashkia Tirane, atehere, do te ishim perballe faktit notelja ka kryer vepër penale! !! Keto akte noteriale janë hartuar nga Notere M.D në përputhje të plotë me ligj in në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ka qënë prezente në Greqi noterja në momentin e leximit dhe nënshkrimit të kontratës dhe prokurës nga ana e Z. Dimitrios Dionysopoulos. Vec sa me siper theksojme se keto dokumenta jane akte noteriale, te hartuara nga nje person i cili ushtron veprimtari publike sic eshte noteri dhe per pasoje perbejne akte zyrtare. Aktet zynare perbejne prove te plote per vertetesine e deklarimeve te bera pelpara nenpunesit publik si dhe per faktet qe kane ngjare ne prani te tyre, ose per veprimet e kryera prej tyre. Kunder permbajtjes se akteve zyrtare lejohet te provohet e kunderta vetem nese ato goditen per fallsitet. Per aq kohe sa aktet noteriale nuk jane goditur per fallsitet cmojme se si Bashkia Tirane ashtu edhe shoqeria "Alko-Impex General Construction" sh.p.k nuk kane te drejte te dyshojne per vertetesine e permbajtjes se tyre, por duhet ti marrin te mireqena deklarimet e pasqyruara ne to. Kjo ne perputhje edhe me nenin 47 teligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, sipas te cilit "Autoriteti Kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, qe paraqet të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese". Per sa më siper, nese Autoriteti Kontraktor dhe shoqëria "Alko Impex General Construction" kanë dyshime per vertetesine e dokumenteve, ata kane cdo te drejte te ndjekin hapat ligjor perkates. Theksojme edhe njehere se BOE "Shpresa" shpk dhe "Dion Texnjkh A.E", duke ju referuar sqarimeve të përmendura më lart: Nuk ka paraqitur as një të dhëne të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi.

Akoma me tej, vetem duke u bazuar ne nje vertetim te marre ne menyre jo te rregullt nga sistemi TIMS per Z. Dimitrios Dyonisopoulos qe nuk ka hyre ne Shqiperi, asnje nuk ka te drejten e aplikimit pervec prokurorise, gjykates, vete personit ose kushdo me prokure te posacme nga vete personi. Pra Bashkia Tirane bazohet ne menyre te njeanshme ne nje vertetim te marre jo ne menyre ligjore ne kete menyre duke bashkepunuar me operatorin ankimues dhe duke mos kerkuar asnje sqarim nga ana e BOE "Shpresa shpk" dhe Dion Texnikh A.E.

Per kete shkak, cmojme se edhe ky pretendim i marrë në shqyrtim nuk qendron.

2. Lidhur me arsyen e skualifikimit, Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për Vitin 2017 "pasi referuar Ekstraktit të Regjistrat Tregëtar të shoqërisë "Shpresa" shpk, në të cilën rezultoi se vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit në Qarkun Berat janë si më poshtë vijon: Berat, Lagjja Kushtrim, Spitali Rajonal Berat dhe Berat, Poshnje, Kati i Pare, Reparti Ushtarak Nr.1030 Poshnje, ndërkohë që shoqëria "Shpresa" shpk nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 nga Bashkia Berat cka bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 11 të ligjit 30.10.2016, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. dhe kthim përgjigjes nga Bashkia Tiranë sqarojmë si më poshtë:

Në kuadër të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mosdiskriminimit të tyre, autoriteti kontraktor duhet të mbajë të njëjtën linjë gjykimi dhe qëndrimi, pasi për fakte të njëjta nuk mund të veprojë në mënyra të ndryshme duke skualifikuar një operator ekonomik dhe duke kualifikuar tjetrin. KSHA ka skualifikuar për herë të dytë BOE "Shpresa" shpk dhe "Dion Texnikh A.E" duke bërë vlerësime të ndryshme dhe duke mos mbajtur të njëjtin qëndrim.

Në dijeninë tonë Operatorët e kualifikuar në Procedurat “Shërbimi i Pastrimit të Tiranës, Zona II, III dhe IV nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, ku më tej ka dhe operatorë ekonomikë të cilët kanë të rregjistruar vetëm adresën qendrore dhe asnjë vend tjetër ushtrimi aktiviteti ku sipas kontratave të paraqitura rezulton e kundërta dhe rrj edhimisht nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.

Për sa më lart Autoriteti Kontraktor nuk ka mbajtur të njëjtën linjë gjykimi për të njëjtat fakte të paraqitura.

Në kthim pergjigjen e ankesës tonë, KSHA gjykon se vetë në hartimin e kriterëve të vecanta të kualifikimif. Ajësia e Prokurimit ka theksuar pavarësisht se nuk e ka shprehur se operatorët

pjesëmarrës duhet të dorëzojnë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga taksat vendore, në cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas QKR.

Sqarojmë se Dokumentat Standarde të Tenderit nuk kanë vend për gjykim apo interpretim por duhet të plotësohen sipas pikave të kërkuara. Pavarësisht se Njësia e Prokurimit pretendon se e ka “theksuar” që operatorët pjesëmarrës duhet të dorëzojnë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga taksat vendore, në cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas QKR, në dokumentat standarde të tenderit nuk është përcaktuar.

Pavarësisht sa më lart edhe pse kjo pikë lë vend për interpretim nga mënyra si është përcaktuar, shoqëria jonë e konsideron të arsyeshme që ky kriter është gjithëpërfshirës, për këtë arsye ka paraqitur 7 vërtetime ku janë paguar taksat vendore për 11 vende të ushtrimit të aktivitetit.

Akoma më tej, referuar shqyrtimit sa më të drejtë, KSHA është bazuar në Vendimin e KPP 709/2017 plka III.1.5. ku KPP konstaton se pjesëtari i bashkimit të operatorëve “A. C ” sh.p.k. nuk ka dorëzuar asnjë document që të vërtetojë [...]”.

Ne vendimin e KPP, qendrimi i mbajtur nuk ka asnje ngjashmeri me rastin konkret pasi eshte paraqitur vërtetim vetëm nga njëri prej pjesëtarëve të këtij bashkimi operatorësh, ku në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, duhet të dëshmojnë se kanë shlyer detyrimet mbi taksat vendore të gjithë pjesëtarët e bashkimit dhe jo vetëm një prej tyre. Ndërkohë që nga ana e shoqërisë “Shpresa” shpk përvecc zyrës qendrore janë paraqitur edhe 7 (shtatë) vertetime te tjera per 11 vende te ushtrimit te aktivitetit.

Ju informojmë se shoqëria “Shpresa” shpk ka paguar taksat vendore në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore, ku Pika 2 thote: Deryrimi i taksës për t’u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe riregjistrimit të tij

Referuar VKB Nr 59 date 30.12.2015 Per kategorine II Biznesi detyrimi paguhet brenda dates 30 prill. A ari i pageses per detyrimet e lindura pas dates 20 prill eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit ku shoqeriajone i ka permbushur ne menyre korrekte piken si me lart. Referuar Ekstraktit te QKB, ne qarkun Berat rezulton se shoqeria “Shpresa” shpk ka te rregjistruara dy adresa: Berat Lagjia Kushtrim, Spitali Rajonal Berat, kati I dhe Berat Poshnje, Kati I Pare.

Per te dyja adresat jane bere pagesat ne përputhje me nenin 11 të ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore dhe VKB Nr 59 date 30.12.2015 Adresa Berat Lagjia Kushtrim, Spitali Rajonal Berat, kati I sipas ekstraktit te QKB, megjithese eshte hapur ne nje periudhe te mëvonshme, pagesa është kryer brenda afatit ligjor nga hapja e kësaj adrese në datë 13.07.2017 në përputhje të plotë me pikën 2 të nenit 11 të ligjit 30.10.2016, “Për sistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.(Bashkelidhur mandat pagesat).

Për sa më lart, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevoj shme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera flzike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, në aspektin e mosqënies debitor në shlyerjen e detyrimeve flnanciare, siç është rasti konkret për likuidimin e taksave vendore.

Nëpërmjet dorëzimit të dokumentit të lëshuar nga organi i pushtetit vendor i cili konfirmon pagimin e detyrimeve për taksat vendore, arrihet të vërtetohet në këtë mënyrë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, si subjekte tatimpagues/taksapagues, janë korrekt në ekzekutimin e detyrimeve që parashikon legjislacioni në fuqi. Në kushte të tilla, paraqitja e këtyre dokumentave janë tërësisht të mj aftueshëm për të provuar se sa i takon gjendjes financiare rezulton të jemikorrekt në pagimin e detyrimeve ekonomike e për njëdhjm gëzojmë dëshminë e mjaftueshme lidhur me kapacitetin ekonomik si operator ekonomik konkurrues në këtë procedurë prokurimi.

Qe shoqeria “Shpresa” sh.p.k ka kapacitet teknik e financiar per te permbushur sherbimin e prokuruar rezulton i provuar edhe nga fakti qe kjo shoqeri, përvec zyrës qendrore, ka të rregjistruara edhe 11 (njëmbëdhjetë) vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit per te cilat ka paguar brenda afatit të përcaktuar të gjitha detyrimet në Bashkitë përkatëse. Evidentojme gjithashtu se referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregëtar shoqëria j onë i rregjistron vazhdimisht dhe rregullisht cdo vend të ushtrimit të aktivitetit, në dallim nga shoqeria “e kualifikuar” nga ana e Bashkise Tirane “Alko Impex General Construction” sh.p.k, që ka të rregjistruar vetëm zyrën qendrore dhe asnjë vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit me cëllimin e vetëm të shmangies së detyrimeve sic rëndom vepron kjo shoqëri. Midis vendeve te shumta që ushtron aktivitet kjo shoqëri në qytetin e Kavajës ushtron aktivitet me objekt “Shërbim pastrami të qytetit të Kavajës” të cilin nuk e ka të regjistruar në QKB dhe rrjedhimisht nuk paguan asnjë detyrim.

Arsyeja e mësipërme e skualifikimit nuk qëndron.

Nga ana tjetër kualifikimi i operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” shpk është në kundërshtim të hapur me LPP duke u favorizuar në mënyrë të padrejtë dhe abusive [...]

Lidhur me pretendimet e mësipërme KSHA ka vlerësuar sipas nenit 63, pika 1 ku kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të demtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, ankimuesi edhe pas ankimit rezulton I skualifzkuar nga procedura e prokurimit, atëhere ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshem për të mbrojtur.

[...] sipas KSHA shoqëria “Shpresa” shpk duhet të skualifikohet edhe pse i permbush te gjitha kriteret për kualifikim duke i kursyer buxhetit të shtetit një vlerë prej dhe nga ana tjetër shoqëria “Alko Impex General Construction” duhet të ngelet e kualifikuar pavarësisht parregullsive të theksuara në dokumentacion. Autoriteti kontraktor ka shkelur në mënyrë të hapur Ligjin e Prokurimit Publik dhe nuk ka respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, ku përcaktohen parimet e përzgjedhjes së fituesit, citoj . . . “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”.

Për sa më sipër, në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe DST kërkojmë:

1. Të anulohet vendimi i KSHA-së
2. Të bëhet kualifikimi i ofertës sonë dhe të shpallemi ofertë fituese

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 101/2 prot., datë 12.02.2018, me lëndë “Kërkesë e përsëritur për informacion dhe dokumentacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i është ridrejtuar autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë, për dërgimin e dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar me vendimin e pezullimit nr. 101/1 prot., datë 26.01.2018.

II.10. Operatori ekonomik ankimues me shkresën nr. 38 prot., datë 22.02.2018, protokolluar pranë KPP-së në datën 22.02.2018 dhe shkresën nr. 39 prot., datë 26.02.2018, protokolluar pranë KPP-së në datën 26.02.2018, ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues sqarues në lidhje me ankesën e paraqitur prej tij në datën 24.01.2018.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 4143/1 prot., datë 09.02.2018, protokolluar me tonën në datën 14.02.2018, me objekt “Dërgim informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”; shkresës nr. 6817/2 prot., datë 20.02.2018, protokolluar me tonën në datën 20.02.2018, me objekt “Dërgim informacioni lidhur me procesin e hetimit për operatorin ekonomik “Shpresa” shpk për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”; shkresës nr. 4143/3 prot., datë 26.02.2018, protokolluar me tonën në datën 28.02.2017, me objekt “Ridërgim informacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”; është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnkh A.E.” se arsyeja e skualifikimit: “Operatori ekonomik “Shpresa” sh.p.k. nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar të dokumentave të tenderit: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2017” pasi referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të shoqërisë “Shpresa” sh.p.k., në të cilën rezulton se vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit në Qarkun Berat janë si më poshtë vijon: Berat, Lagja Kushtrim, Spitali Rajonal Berat dhe Berat, Poshnje, Kati i parë, Reparti Ushtarak Nr.1030 Poshnje, ndërkohë që shoqëria “Shpresa” sh.p.k. nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 nga Bashkia Berat çka bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 11 të ligjit 30.10.2016 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pikat 3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Dion Texnikh A.E.”, nga ku shoqëria “Shpresa” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 84% të punëve dhe shoqëria “Dion Texnikh A.E.” sh.p.k. merr përsipër 16% të punëve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Shpresa” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se, shoqëria “Shpresa” sh.p.k. ka paraqitur për përmbushjen e kriterit si më sipër cituar, dokumentacionin si më poshtë vijon:

Ekstrakti i regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, si edhe Ekstraktin Historik, sipas të dhënave të së cilave në pikën 7 Zyra Qendrore e shoqërisë në Shqipëri deklarohet adresa Lezhë, ndërsa në pikën 15 Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit deklarohen adresat:

Berat Berat BERAT Lagja Kushtrim, Spitali Rajonal Berat, kati 1

Tirane Tirane TIRANE Lagja 4, Mathieu me nr. identifikimi 75453, me targa AA 735 ME

*Fier MBROSTAR URA MBROSTAR URA Rruga Nacionale Fier Lushnje, Mbrostar Ura ,
Reparti i Nderhyrjes se shpejtë, Fier, kati 1*

Tirane Tirane TIRANE AA 847 KL

Tirane Tirane TIRANE AA 299 MX

Tirane Tirane TIRANE AA 768 EH

*Tirane Farke FARKE DAF 150, me Nr. identifikimi XLRAESSCEOLIGS388, me targa AA 192
MA*

Tirane Tirane TIRANE Volksäagen Caddy me targa TR 4361 U

Tirane Tirane TIRANE AA 931 PA

*Tirane Tirane TIRANE SSANGYONG REXTON, me Nr. identifikimi KPTGOBIDS3P070179, me
targa AA 161 KU*

Vlore Vlore VLORE Pashaliman, Prona nr 937, Flotilja Detare Pashaliman

*Durres Durres DURRES Lagjja 111218, Rruga Aleksander Goga, kati I, Spitali Rajonal Durres
Tirane Tirane TIRANE AA 342 E0
Tirane Farke FARKE Mercedes Benz me nr. identifikimi ĒDB9505321K758016, me targa AA
182 MA
Tirane Tirane TIRANE AA 003 EL
Tirane Tirane TIRANE AA 824 GC
Tirane Vaqarr VAQARR Vaqarr, Toke Bujqesore, zona kadastrale nr 3712
Tirane Tirane TIRANE Mjeti tip ATP Kama me targe TR 1785 T
Tirane Tirane TIRANE AA 710 PK
Tirane Tirane TIRANE AA 607 PE
Tirane Tirane TIRANE Renault me Nr. identifikimi VF622AC800010113, me targa AA 685 LY
Tirane Tirane TIRANE Bulevardi Gj ergj Fishta, Kulla nr.2, kati 1
Tirane Tirane TIRANE Mercedes Benz me targe TR 7513 R
Tirane Tirane TIRANE AA 628 MH
Tirane Tirane TIRANE AA 846 NX
Tirane Tirane TIRANE AA 239 PS
Tirane Tirane TIRANE AA 694 OM
Tirane Tirane TIRANE Iveco Magirus me targa AA 354 AG
Tirane Tirane TIRANE AA 740 J D
Tirane Tirane TIRANE Iveko Magirus me nr. identifikimi ĒJMAIVP0004254091, me targa AA
395 LY
Tirane Zall Herr Zall Herr Rruga Zall Herr, Reparti 1050 Tirane Tirane TIRANE Benz Autobot
me nr. identifikimi ĒDB9505341K394244, me targa AA 297 LY
Berat Berat BERAT Poshnje, Kati i Pare, Reparti Ushtarak Nr.1030 Poshnje
Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 7, Rruga Gjergj Fishta, Kulla Nr. 2, Kati 2
Tirane Tirane TIRANE Man me nr. identifikimi ĒMAM059465Y018540, me targa AA 243 JZ
Tirane Tirane TIRANE Vaqarr, Reparti i Nderhyrjes se Shpejte.
Tirane Tirane TIRANE AA 491 PJ
Tirane Tirane TIRANE Mercedes Benz me nr. identifikimi ĒDB9505321K368242, me targa AA
394 LY
Tirane Kashar KASHAR PIAGGIO (1), me Nr. identifikimi ZAPS8500000456958, me targa AA
683 ME
Tirane Tirane TIRANE AA 985 KN
Vlore Vlore VLORE Rruga Dytesore Bestrove, Godina Nr.16, Ish Reparti Ushtarak (5001)
Tirane Tirane TIRANE Mercedes Benz me nr. identifikimi ĒDB9506251K400568, me targa AA
396 LY
Tirane Kashar KASHAR PIAGGIO (2), me Nr. identifikimi ZAPS8500000456959, me targa AA
684 ME
Tirane Tirane TIRANE TR 7856 K.*

III.1.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se ka mangësi, pasi nuk është paraqitur vërtetim për pagesën e taksave vendore nga Bashkia Berat për vitin 2017, bashki në të cilën gjatë vitit 2017 ka ushtruar aktivitet shoqëria ankimuese, referuar kjo adresave dhe vendeve të ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (për vitin

2017 rezulton se ky operator ekonomik ushtron aktivitet në dy adresa për këtë bashki - që nga data 26.04.2017 për adresën Berat Poshnje Kati 1, Reparti Ushtarak Nr. 1030 Poshnje dhe nga data 13.06.2017 për adresën Beat, Lagja Kushtrim, Spitali Rajonal Berat, kati 1).

III.1.5. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: “Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës konstaton se shoqëria “Shpresa” sh.p.k. ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në vendin e ushtrimit të aktivitetit Bashkia Ura Vajguore, ndërkohë që nuk është dorëzuar asnjë vërtetim në lidhje me vendin e ushtrimit të aktivitetit Bashkia Berat, ku referuar ekstraktit mbi historikun e shoqërisë “Shpresa” sh.p.k. rezulton se ky vend ushtrimi aktiviteti është hapur në vitin 2017 dhe vijon të jetë aktiv në këtë bashki. Në këto kushte bazuar në nenin 46 të LPP, i ndryshuar, nenin 53, pika 3 të LPP, të ndryshuar dhe nenin 74 pika 3 të VKM 914, të ndryshuar, KSHA gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar ankesës së dorëzuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. dhe “Dion Texnikh” A.E i referohet termi “Qarku Berat”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nënvizon se referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në nenin 3;4 dhe vijues parashikon se detyrimet që rrjedhin nga tatimet dhe taksat vendore lindin dhe paguhen pranë cdo njësie të ushtrimit të aktivitetit në bashkinë përkatëse. Në asnjë rast ligji i posaçëm nuk parashikon lindjen dhe pagimin e detyrimeve në Qark, por në Bashki. Subjekti megjithëse ushtron aktivitet tregëtar pranë Bashkisë Berat dhe ndaj së cilës kanë lindur detyrimet përkatëse, nuk disponon asnjë vërtetim të lëshuar nga kjo bashki për shlyerjen e taksave vendore.

Gjithashtu referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, ku parashikohet se “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017; Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

Sa më sipër, KSHA gjykon se vetë në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, Njësia e Prokurimit ka theksuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dorëzojnë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga taksat vendore, në cdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas QKR. Pra shoqëria disponon aktivitet tregëtar të regjistruar në QKR në Bashkinë Berat, ndërkohë që nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e detyrimeve në këtë bashki. Për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, në lidhje me kërkimin e mësipërm, KSHA i drejtohet për interpretim edhe vendimeve të organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, Komisioni i Prokurimit Publik, ku në vendimin KPP 709/2017 ka mbajtur të njëjtin qëndrim me arsyetimin e mësipërm në lidhje me plotësimin e vërtetimit për taksat vendore. Sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron”.

III.1.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.7. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”,* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”,* i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.8. Në nenin 11, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”,* i ndryshuar, parashikohet se: *“[...]Detyrimi i taksës për t’u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe reregjistrimit të tij[...].”*

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Shpresa” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht, ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin e tij sipas ekstraktit të QKR-së si edhe për periudhën e kërkuar sipas përcaktimit të bërë në dokumentat e tenderit, duke mos përmbushur kriterin për paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve vendore të vitit 2017, të përcaktuar tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar, në dokumentat e tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Shpresa” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë që kanë shlyer taksat vendore për vitin 2017 të parashikuara nga pushteti vendor, nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit ku përfshihen të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit të tyre pranë çdo organi të pushtetit vendor, përgjatë një periudhe të caktuar kohore siç kërkohet në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

III.1.10. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.11. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.12. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për paraqitjen e mandateve të pagesës së taksave bashkëlidhur këtij ankimi, duke u pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik fakti i mosparaqitjes së vërtetimit të kërkuar në dokumentat e tenderit për pagesën e detyrimeve vendore nga çdo organ i pushtetit vendor ku operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet, sqarojmë se, nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve *para hapjes së ofertave*.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.13. Akoma më tej, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.” sh.p.k., për skualifikimin e padrejtë të tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interesin e ankimesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Akoma më tej, në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimes, përsa i përket vërtetimeve të lëshuara nga Bashkia Selanik, kontratës së bashkëpunimit dhe prokurës, referuar edhe informacionit të autoritetit kontraktor (citojmë) *...këto fakte të ngritura në pretendim janë dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të nenit 13 të lex specialis, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ në lidhje me këto pretendime.*

Gjithashtu, referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. Prot. 6817/2, datë 20.02.2018, të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 101/4 prot., datë 20.02.2018, duke qenë se konstatohet se autoriteti kontraktor është organi që ka kryer verifikimet përkatëse në lidhje me dokumentacionin e operatorit ekonomik ankimes, rekomandojmë që, referuar materialeve, dokumentacionit dhe hetimeve të kryera, këto të fundit të dërgohen nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë pranë organeve përkatëse të hetimit.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Construction” d.sh.h., Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.4.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.*

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislativi janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimes edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për rrjedhojë, ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” sh.p.k. & “Dion Texnikh A.E.” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-21386-07-18-2017, me objekt “*Shërbimi i pastrimit të zonës Tirana III*”, me fond limit 494.683.652 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 27.09.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 101 Protokolli

Datë 24.01.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha